



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I QARKUT KORÇË**

Korçë, më 22.12.2021

**VENDIM**

Nr. 19 datë 22/12/2021

**“PËR DHËNIE SHITESE PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR”**

Bazuar në ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, në nenin 5 të ligjit 7703 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.429, datë 12.09.2002 “Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posacme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posacme shtetërore”, pasi shqyrtoi propozimin e paraqitur nga Kryesia, Këshilli i Qarkut Korçë,

**VENDOSI:**

1. Ti propozojë Këshillit të Ministrave dhënien e shtesës të pensionit të posaçëm shtetëror:
  - Petrika Llazi Riza, lindur në Bulgarec, Korçë më 01.06.1947
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e financës, zhvillimit ekonomik e shërbimeve.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I KESHILLIT TË QARKUT**

**ANAVERUSHI**

Konceptoi: Gjergji Kristo  
Sekretari i Këshillit të Qarkut: Bashkim Muço





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KËSHILLI I QARKUT KORÇË

### RELACION

#### Për Përfitim të pensionit të posaçëm shtetëror

#### Për Z. Petrika Riza

Në datën 15/11/2021, pranë Këshillit të Qarkut Korçë, ka paraqitur kërkesën për të propozuar Këshillit të Ministrave caktimin e një shtese pensioni të posaçëm shtetëror për pensionin që i takon nga sigurimet shoqërore, z. Petrika Llazi Riza.

Nga dokumentacioni që i ka bashkëlidhur kërkesës rezulton se kërkuesi i përmbush kriteret ligjore të përcaktuara në VKM Nr. 429, Datë 12.9.2002 “Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore” që Këshilli i Qarkut Korçë ti propozojë Këshillit të Ministrave caktimin e një pensioni të posaçëm shtetëror.

I lindur në Bulgarec, Korçë më 01.06.1947, z. Petrika Riza e ka filluar karrierën e tij që në moshë të re ku prej vitit 1969 ka punuar për 6 muaj pranë Kinostudios. Ky ka qenë edhe fillimi i një karriere të gjatë me plot role si në teatër por edhe në filma, ku më pas prej vitit 1970 e deri në 2013 ka qenë aktor në trupën e Teatrit “Andon Zako Çajupi” të Korçës, por luajtur edhe në filma të ndryshëm. Prej vitit 1998 deri në vitin 2004 ka qenë drejtor i Teatrit “Andon Zako Çajupi” dhe në vitin 2004 ka iniciuar Festivalin Teatëror të Komedisë “Ballkan 2000”. Karriera e gjatë e aktorit Petrika Riza shoqërohet edhe me një sërë titujsh dhe medaljesh ndër të cilat vlen të përmendim:

Në vitin 1985 është dhënë Medalja “Naim Frashëri” klasi III dhe në vitin 1988 i jepet titulli “Naim Frashëri i Artë”.

Në vitin 2007 në spektaklin e organizuar nga Bashkia Korçë “Protagonist 2000” i jepet çmimi “Aktori më i mirë”.

Në vitin 2021 nga Presidenti i Republikës i është dhënë titulli “Mjeshtër i Madh”.

Z. Petrika Riza i përmbush parashikimet e nenit 5 pika b të ligjit 7703 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.

Kërkesa përmban gjeneralitetet, e kërkuesi dhe është e shoqëruar me dokumentat, si vijojnë:

- Fotokopjen e letërnjoftimit elektronik dhe çertifikatën e gjendjes civile;
- Vërtetim nga Sigurimet Shoqërore për masën e pensionit;
- Kopjet e noterizuara të dokumentave që vërtetojnë meritat e veçanta si titull, medaljet, urdhërat etj;

Dokumentacioni i paraqitur është konform VKM Nr.429, datë 12.09.2002 "Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posacme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posacme shtetërore".

**KRYETARI I KËSHILLIT TË QARKUT**

**ANA BERUSHI**

Konc. Gj. Kristo

